

URDHËR
Nr. 190, datë 4.5.2018

**PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATËS SHËNDETËSORE VETERINARE
QË SHOQËRON LËVIZJEN DHE TRANSPORTIN E NGARKESAVE ME LËKURË
DHE PRODUKTE ME ORIGJINË SHTAZORE JO PËR KONSUM NJERËZOR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të certifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave të produkteve me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Çdo ngarkesë me produkte me origjinë shtazore, jo për konsum njerëzor që lëvizin dhe transportohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të shoqërohet me certifikatë shëndetësore veterinarë sipas modelit të pikës 1, të këtij urdhri.

3. Institucionet përgjegjëse për lëshimin e certifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave me produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor sipas neneve 54 dhe 55, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të marrin të gjitha masat për prodhimin dhe pajisjen me certifikatën veterinarë sipas modelit të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Shërbimi Veterinar Rajonal dhe strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Niko Peleshi


CERTIFIKATË SHËNDETËSORE VETERINARE

Që shoqëron lëvizjen dhe transportin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të ngarkesave me produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor

Nr.
serial

--	--	--	--	--	--	--	--

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

1. Identifikimi i produktit: Lloji i produktit: _____ Nr. identifikimit (*) _____ — Nr. i copëve: _____ Tipi i ambalazhit: _____ Pesha neto: _____, njësia: _____	2. Certifikatë nr.: _____ — 3. Shërbimi Veterinar: _____ Nr. i vulës së miratuar: _____ — 4. Vendi i origjinës Thertore/ stabiliment përpunimi _____ — Nr. i miratimit: _____ — 6. Marrësi Emri: _____ Adresa: _____
5. Prejardhja e kafshëve: Adresa e fermës së origjinës: _____ Kodi i fermës: _____ Mjeti i transportit: _____ —	
Informacion shëndetësor Unë, i nënshkruari veterineri zyrtar deklaroj, se: 1. Produkti origjinën nga kafshë të shëndetshme, të cilat i janë nënshtruar kontrollit veterinar <i>ante</i> dhe <i>post-mortem</i> dhe kanë rezultuar të pastra nga sëmundjet infektive në kafshë dhe njerëz dhe mishi i tyre është konsideruar i përshtatshëm për konsum njerëzor. 2. Produktet janë grumbulluar nga thertore/stabilimente përpunimi të miratuara të cilat janë nën kontroll të vazhdueshëm, kanë vulën e kontrollit veterinar dhe janë përgatitur, manipuluar dhe transportuar në përputhje me rregullat dhe normat e higjienës sanitaro-veterinare. 3. Produktet i janë nënshtruar dezinfektimit apo sterilizimit dhe nuk përmbajnë mikroorganizma patogjenë për kafshë e njerëz. 4. Dispozita të veçanta: _____ _____ —	
Veterineri zyrtar: _____ Emri Mbiemri (me germa Kapitale), Firma  Vula	

(*) Kur numri i kafshëve është më shumë se 1 (një) numrat e identifikimit jepen në aneksin bashkëngjitur kësaj certifikate.

Nr.

--	--	--	--	--	--	--	--


serial

Data e lëshimit ____ / ____ / ____

Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji	Nr.	Numër identifikimi i kafshëve									Lloji
1	AL										21	AL									
2	AL										22	AL									
3	AL										23	AL									
4	AL										24	AL									
5	AL										25	AL									
6	AL										26	AL									
7	AL										27	AL									
8	AL										28	AL									
9	AL										29	AL									
10	AL										30	AL									
11	AL										31	AL									
12	AL										32	AL									
13	AL										33	AL									
14	AL										34	AL									
15	AL										35	AL									
16	AL										36	AL									
17	AL										37	AL									
18	AL										38	AL									
19	AL										39	AL									
20	AL										40	AL									

Veterineri zyrtar _____
Emri Mbiemri (me germa kapitale)

Firma



Lloji do të shënohet me inicialet: G – gjedh; L – të leshta; D – të dhirta; P – derra;